

AKTI I THEMELIMIT
I
SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“HUREN” sh.p.k

Themeluesi qe nenshkruan me poshte eshte si vijon:

Z. Ahmet Emin Sonmez, i datelindjes 02/06/1985, i biri i Mustafa Kemal-it, lindur ne Nigde/Turqi dhe banues ne Yahyakaptan mahallesi dogal sokak armadakent 2. Etap evleri F9 blok daire 2 / Izmit / Kocaeli / Turqi, identifikuar me pasaport nr.S20143105 dhe nr personal 36352855524 madhor perfaqesuar me prokure nga Ergys Dervishi, me zotesi te plote juridike per te vepruar,

Qe ne vijim do te quhet Ortaku i Shoqerise “HUREN” sh.p.k

Sot me date **08.08.2023**, bazuar ne vullnetin e tij te lire dhe ne perputhje me ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, vendosi te themeloje Shoqerine Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar, ne baze te kushteve qe vijojne:

Kreu I
OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK

Neni 1

Objekti i shoqerise

Shoqeria Tregtare “HUREN” sh.p.k, ka si objekt veprimtarie:

Mjek anestezist reanimator. Sherbime mjeksore. Hapjen e kabineteve apo klinikave mjekesore. Sherbime ambulatorie, pediatrike etj. Shit blerje me pakice e shumice te aparaturave mjekesore, Konsulece. Trajnime mjekesore dhe turizem shendetsor.

Neni 2

Emertimi dhe Selia Juridike e Shoqerise

Ortaku vendosi qe shoqerine ta emertojne “HUREN” sh.p.k

Selia juridike e Shoqerise ndodhet ne Rruga Kavajes, Ndertesa 1, Hyrja 11, Apartamenti 3, Kodi postar 1001, Tiranë

Shoqeria mund te krijojte qendra sekondare, filiale, zyra perfaqesimi e agjenci ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit.

Neni 3

Forma Juridike

1. Shoqeria eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi
2. Me vendim te ortakut mund te ndryshoje formen juridike te Shoqerise, ne qofte se ne te ardhmen krijohen premisa me te favorshme per funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Ne kete rast ortakut do ta pershtasi Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqerise, si dhe do te bejne regjistrimin e saj ne regjistrin tregtar, ne organet kompetente shqiptare.
3. Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar nga organet kompetente dhe ne perputhje me ligjin.
4. Shoqeria do te kete vullen e saj.

Kreu II **TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA**

Neni 4

Te drejtat e Shoqerise dhe te Ortakut

1. Shoqeria ka te drejte te lidhe marreveshje dhe te nenshkruaje kontrata ne territorin e Shqiperise dhe jashte saj.
2. Shoqeria gezon te drejten te krijojte pasuri materiale dhe intelektuale.
3. Shoqeria ka te drejte te marre pjese si ortak ne nje shoqeri tjeter ose ndermarrje te ndryshme ne Shqiperi ose jashte saj, ne perputhje me legjislacionin shqiptar.
4. Shoqeria pergjigjet ndaj te treteve vetem dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqeror te derdhur dhe me te mirat e pasurise se saj.
5. Ortaku merr pjese ne administrimin e veprimtarise se shoqerise ne perputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin, vet ose nepermjet perfaqesuesve te tij.
6. Ortaku ka te drejte te marri te gjitha informatat qe kane te bejne me veprimtarine prodhuese, projektuese, realizuese e tregetare te shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike etj.

Neni 5

Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise eshte me afat te pacaktuar.

Kreu III **KAPITALI THEMELTAR**

Neni 6

Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar eshte **100.000 (njqind mije) Leke**. 1 (nje) kuote gjithsej.

Ortaku i shoqerise eshte:

1. **Ahmet Emin Sonmez**, zotërues i 1 (nje) kuote me vlere 100.000 lek, qe perfaqeson **100% (njqind %)** kapitalin themeltar të shoqërisë;

Kreu IV **PERSONALITETI JURIDIK**

Neni 7

Shoqeria fiton personalitetin juridik ne ditën e rregjistrimit te saj ne Rregjistrin Tregtar ne Qendren Kombetare te Biznesit, si dhe fillon veprimtarine e saj me marrjen e licences te ushtrimit se veprimtarise.

Kreu V **ADMINISTRIMI**

Neni 8

Shoqeria do te administrohet nga administratori **Ahmet Emin Sonmez** i cili perfaqeson shoqerine ne marredheniet me te tretet per nje periudhe **5 (pese)** vjecare dhe me te drejte rizgjedhje.
Administratori mund t'i delegoje kompetencat e saj me shkrim ne formen e autorizimit ose me prokure.

Kreu VI

DISPOZITA TE TJERA

Neni 9

Fitimi i realizuar nga Shoqeria, pas shlyerjes se detyrimeve ligjore, do t'i mbetet Ortakut te saj, ta ndaje si dividend apo ta shtoje ne kapitalin e shoqerise.
Ky Akt shtypet dhe nenshkruhet ne 2 (dy) kopje, te gjitha me te njejten vlere ligjore.
Nje kopje qendron ne dokumentacionin baze te shoqerise.

Ortaku Themelues

Ahmet Emin Sonmez
Perfaqesuar me prokure nga
Ergys Dervishi

ERGYS DERVISHI

